

Emertimi dhe Forma ligjore:

NIPT –i:

Adresa e Selise:

Data e krijimit:

Nr. I Regjistrimit Tregtar

Veprimtaria Kryesore:

**“SHTYPSHKRONJA E LETRAVE ME VLERË” SHA
J61827076U**

Tirane

29.06.1994

4

**Shtypshkrimi i te gjitha llojeve te biletave,
faturave dhe formulareve**

PASQYRAT FINANCIARE

(Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit Nr 2
dhe Ligjit Nr. 9228, date 29.04.2004 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”)

VITI 2019

Pasqyrat Financiare jane individuale

Pasqyrat Financiare jane te shprehura ne Lek

Pasqyrat Financiare nuk jane te rrumbullakosura

Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare nga 01.01.2019-31.12.2019

Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare Viti 2019



Pasqyra e Pozicionit financiar

AKTIVE	Shenime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Aktivitet afatshkurtra			
Aktivitet monetare			
Llogari rrjedhse bankare		186,585,609	214,045,256
Arke		72,893	95,725
Totali I Aktiveve monetare	4	186,658,502	214,140,981
Investime			
Të drejta të arkëtueshme			
Nga aktiviteti i shfrytëzimit		162,750,182	103,939,122
Tvsh kreditore			1,914,476
Tatim fitimi I mbipaguar, tatim burim I mbipaguar			4,375,346
Te tjera		4,375,346	4,375,346
Debitore te ndryshem(kalim fond shoqeri falimentim)		100,000,000	
Totali I te drejtave te arkëtueshme	5	267,125,528	110,228,944
Inventarët			
Lende e pare dhe materiale te konsumueshme		94,916,319	118,088,677
Gjysme produkte			
Produkte te gatshme		430,436	766,332
Totali I inventarit	6	95,346,755	118,855,009
Shpenzime të shtyra			
Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara			
Totali I aktiveve afatshkurtra		549,130,786	443,224,934
Aktive afatgjata			
Aktive financiare			
Aktivitet materiale			
Toke dhe Ndertesa		39,653,937	41,740,986
Makineri e pajisje		47,287,503	58,747,400
Te tjera, Mjete Transporti		1,958,125	2,447,656
Inventar ekonomik		1,976,313	2,514,241
Inventar imet		2,909,730	2,467,161
Totali I aktiveve materiale	7	93,785,608	107,917,444
Aktivitet biologjike			
Aktive jo materiale:	8	272,039	320,046
Aktive tatimore të shtyra			
Kapitali i nënshkruar i papaguar			
Totali I aktiveve afatgjata		94,057,647	108,237,490
Total Aktive		643,188,433	551,462,424
Llogari jashte bilancit , automjet		3,879,000	3,879,000

Administratori

Besmir HYSA

Kryetare Dege Finance

Besjana DERVISHI

Pasqyra e Pozicionit financiar

PASIV	Shenime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Detyrime afatshkurtra:			
<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>		16,401,343	24,298,975
<i>Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>		1,748,234	1,721,480
<i>Të pagueshme për detyrimet tatimore</i>		10,557,857	4,202,588
<i>Të pagueshme për hua</i>		9,564,081	
<i>Te tjera detyrime</i>		88,353	36,450
Shuma detyrime afatshkurtra	9	38,359,868	30,259,493
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		-	-
Të ardhura të shtyra		-	-
Provizione		-	-
Total detyrime afatshkurtra		38,359,868	30,259,493
Detyrime afatgjata:			
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		-	-
<i>Grandet</i>		3,388,795	3,527,349
<i>Kreditor te tjere</i>		4,375,346	4,375,346
Provizione		-	-
Detyrime tatimore të shtyra		-	-
Total detyrime afatgjata	10	7,764,141	7,902,695
Total detyrime		46,124,009	38,162,188
Kapitali dhe Rezervat			
<i>Kapitali i Nënshkruar</i>		430,238,000	160,000,000
<i>Prime me kapitalin</i>			
<i>Rezerva ligjore</i>		22,457,849	19,268,191
<i>Rezerva per investime</i>		54,224,187	269,280,346
<i>Rezerva te tjera</i>		884	924,474
<i>Rezerva te tjera(per shperblime)</i>			34,064
<i>Fitim / Humbja e Vitit</i>		90,143,504	63,793,161
Total kapitali aksionar	11	597,064,424	513,300,236
Totali I kapitalit dhe I detyrimeve		643,188,433	551,462,424
Llogari jashte bilancit automjet		3,879,000	3,879,000

Administratori

Besmir MYSA

Kryetare Dege Finance

Besjana DERVISHI

Pasqyra e performances	Shenime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	12	345,645,793	311,358,868
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit (ndryshim në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces)	13	(335,896)	(661,770)
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	14	(144,246,829)	(131,940,871)
<i>Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme</i>		(144,246,829)	(131,940,871)
Shpenzime të personelit	15	(71,409,905)	(71,831,497)
<i>Paga dhe shpërblime</i>		(61,593,111)	(61,948,323)
<i>Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>		(9,816,794)	(9,883,174)
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale			
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	16	(15,575,844)	(18,542,271)
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	17	(8,316,617)	(13,012,038)
Të ardhura të tjera		389,038	329,214
Rimarje Grandesh		138,554	155,604
te ardhura te tjera		250,484	173,610
Zhvlerësimi i aktiveve dhe investimeve financiare			
Shpenzime financiare		-	-
<i>Shpenzime per interesa</i>			
<i>Te ardhura dhe humbje nga kembimet valutore</i>			
<i>Shpenzime të tjera financiare</i>			
Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet		-	-
Fitimi/Humbja para tatimit	18	106,149,740	75,699,635
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(16,006,236)	(11,906,474)
<i>Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin</i>		(16,006,236)	(11,906,474)
Fitimi/Humbja e vitit	18	90,143,504	63,793,161
Te ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin			
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	18	346,034,831	311,688,082

Administratori

Besmir HYSA

Kryetare Dege Finance

Besjana DERVISHI

		(metoda indirekte)	
Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare	Shenime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit			
<i>Fitim / Humbja e vitit</i>		90,143,504	63,793,161
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>		15,575,844	18,542,274
<i>Vlera kontabel për aktivet jashtë përdorimit</i>			166,198
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>			
<i>Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera</i>		(156,896,584)	(20,332,474)
<i>Rënie/(rritje) në inventarë</i>		23,508,254	2,444,584
<i>Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme</i>		7,961,821	18,940,083
<i>Tatim fitimi I paguar</i>			
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		(19,707,161)	83,553,826
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit			
<i>Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale</i>		(1,396,000)	(2,207,680)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		(1,396,000)	(2,207,680)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit			
<i>Pagese e detyrimeve të huave</i>			
<i>Interes i paguar</i>			
<i>Dividendë të paguar</i>		(6,379,318)	(6,536,382)
Mjete monetare neto nga aktivitetin e financimit		(6,379,318)	(6,536,382)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare		(-27,482,479)	74,809,764
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar		214,140,981	139,331,217
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor		186,658,502	214,140,981

Administratori

Besmir HYSA

Kryetare Dege Finance

Besjana DERVISHI

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto

	Kapitali I regjistruar	Rezerva ligjore dhe te tjera	Rezerva te tjera	Rezerva investimi	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2017	160,000,000	16,000,000	958,538	213,721,098	65,363,821	456,043,457
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:						
Fitimi / Humbja e vitit					63,793,161	63,793,161
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:					-	-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:					63,793,161	65,363,821
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:						
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike						-
Rritje e rezervave		3,268,191		55,559,248	(58,827,439)	-
Divident I paguar					(6,536,382)	(6,536,382)
Transaksione me pronarët						
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike		3,268,191		55,559,248	(65,363,821)	(6,536,382)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	160,000,000	19,268,191	958,538	269,280,346	63,793,161	513,300,236
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2018	160,000,000	19,268,191	958,538	269,280,346	63,793,161	513,300,236
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:						
Fitimi / Humbja e vitit					90,143,504	90,143,504
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:					-	-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:					90,143,504	90,143,504
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:						
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike						-
Rritje e rezervave		3,189,658		54,224,187	(57,413,845)	-
Divident I paguar					(6,379,316)	(6,379,316)
Transaksione me pronarët	270,238,000		(957,654)	(269,280,346)		
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike	270,238,000	3,189,658	(957,654)	54,224,187	63,793,161	(6,379,316)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	430,238,000	22,457,849	884	54,224,187	90,143,504	597,064,424

Administratori

Kryetare Dege Finance

Besmir HYSA

Besjana DERVISHI

SHENIMET SHPJEGUESE

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" sh.a, shoqëri aksionere me kapital të regjistruar prej 160,000,000 lekë, i ndarë në 1,000 aksione me vlerë nominale 160,000 lekë/aksion, tërësisht i paguar, me seli tek ish "Tipografia Ushtarake" Tiranë, e përfaqësuar nga administrator i Shoqërisë Z. Besmir HYSA. Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë gjatë vitit 2019 përbëhet nga Z.Rudolf Papa –Kryetar si dhe anëtarët Znj. Silvia Qesku, Znj. Majlinda Demko, Znj. Dajna Sorensen, Znj.Arjana Dyrmishi, Znj. Diana Dervishi Nr mesatar i të punësuarve gjatë Vitit 2019 është 90 punonjës

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr.64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Shoqëria nuk kryen transaksione në monedhë të huaj

3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

- Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

- Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionet për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit,

mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

- Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

- Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

- Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

- Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

- Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

- Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi. Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiar të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiar të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4 Aktive afatgjata materiale



[Handwritten signature]

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesat	Vlera e mbetur	5%
Makineri e paisje	Vlera e mbetur	20 %
Mobilje për zyren	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Të tjera	Vlera e mbetur	20%
Aktive jo material	Vlera Fillestare	15%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë



[Handwritten signature]

përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13 Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Bilanci kontabel, aktivet

4. Aktive monetare

Gjendja me 31.12.2019 e aktiveve monetare është 186,658,502 leke, e detajuar si me poshte:

Nr	Likuiditete	Viti 2019	Viti 2018
1	Depozita ne banke	186,585,609	214,045,256
2	Para ne arke	72,893	95,725
	Totali	186,658,502	214,140,981

Gjendja e detajuar e bankave me 31.12.2019 është ne tabelen e meposhtme:

Nr	Llogaria bankare	Viti 2019	Viti 2018
1	BKT ne leke	186,585,609	214,045,256
	Shuma	186,585,609	214,045,256

5. Te drejta te arketueshme

Ne kete post paraqiten te drejta te arketueshme me 31.12.2019 ne shumen 162,750,182 leke, si me poshte:

Nr	Te drejta te arketueshme	Viti 2019	Viti 2018
1	Nga aktiviteti I shfrytezimit	162,750,182	103,939,122
a	Te arketueshme nen 1 vit	152,409,750	93,630,760
b	Te arketueshme mbi 1 vit	10,340,432	10,308,362



[Handwritten signature]

2	Tatim fitimi + tatim burim	0	1,914,476
3	Të tjera	4,375,346	4,375,346
4.	Debitore te ndryshem(kalim fond shoqeri falimentim)	100,000,000	
	Totali	267,125,528	110,228,944

Të tjera, ne total 4,375,346 perfaqeson:

Shuma per 3,975,746 leke nje detyrim i cili figuron ne bilanc prej vitit 2009 perfaqeson detyrimin qe ish drejtori Roland Sahatçia ka ndaj shoqerise ne shumen 3,938,475 leke (3879000+59475) dhe Altin Balla ne shumen 37,271 leke, sipas akt kontrollit te auditit te Ministrise se Financave Nr 5895/10 date 30.01.2008,

Shuma per 399,600 lekë konkretisht 373000 leke +26000 leke si me poshte vijon:

Shuma 373 000 leke -Bazuar në Urdhërin e brendshem Nr 40 datë 04.02.2014 kryet njohja si debitore sipas raportit përfundimtare te Auditi Nr 16744/10 dt 14.01.2014 Rekomandimeve Nr 5,6,8 Në total vlera e detyrimit sipas raportit është 509400 lekë konkretisht Adem Rrenga 99000 lekë, Sokol Sheme 135800 lekë, Arben Doci 98200, Besnik Cobaj 98200 lekë dhe Albert Avdulaj 78200. Nga shuma e mësipërme është arritur të kryet vetëm ndalesa ndaj ish Administratorit Z Sokol Sheme në vlerën 138500 lekë mbajtur ne borderote e vitit 2014. Nga sa më lart Debitorë të tjerë sipas rap auditit 2014 është = 509400-135800 = 373600 lekë

Shuma per 26.000 leke - kryet njohja si debitore e Zj ADA GURI sipas raportit përfundimtare te KLSH Nr 1220/11 datë 20.06.2015 Pika B Masa për shpërblim dëmi pika 2. "Shoqëria Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" të marrë masa për arkëtimin e shumës prej 78000 lekë ndaj komisionit të blerjeve të vogla Ada Guri, Alkida Vladi, Ylli Veshi. Punonjesit Y.Veshi dhe A.Vladi kane shlyer detyrimin.

Sa më lart, duhen vlerësuar të gjitha mundësitë ligjore për arkëtimin e tyre (si psh procese Gjyqësore etj) dhe ti paraqitet relacion Juridik Keshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë për Vendim Marje të mëtejshme.

Debitore te ndryshem(kalim fond shoqeri falimentim) , 100 000 000 lekë përfaqëson:

Kalim fondi monetar për disa shoqëri në likuidim sipas Vendimit Nr 125 datë 12.12.2019 të Ministrit Financave dhe Ekonomisë në cilësinë e Aksionerit të vetëm.

Ky transefim likuiditeti është pasqyruar në llogarinë Debitorë të ndryshëm.

6. Inventaret

Ne kete post paraqiten me 31.12.2019 inventar mallra, lende te para, e produkt te gatshem ne shumen 95,346,755 leke, si me poshte:

Nr	Gjendje inventari	Viti 2019	Viti 2018
1	lende e pare dhe materiale te konsumueshme	94,916,319	118,088,677
2	Gjysme produkte		
3	Produkte te gatshme	430,436	766,332
	Totali	95,346,755	118,855,009

Gjendja e mallrave dhe e lendes se pare per prodhim jane te vleresuar me koston e blerjes. Gjate vitit 2019 nuk eshte ndryshuar menyra e mbajtjes se inventarit e cila vazhdon te jete me kosto mesatare.

7. Aktive afatgjata

Gjendja e e aktiveve afatgjata materiale eshte paraqitur me vlere neto me 31.12.2019 ne shumen 93,785,608 leke, si me poshte:

Nr	Emertimi	Ndertesa	Makineri e pajisje	Mjete transporti	Pajisje kompjuterike dhe zyre	Inventar I imet	Totali
I	Aktive afatgjata						

materiale							
1	Gjendja me 31.12.2018	65,263,949	189,597,194	7,382,390	9,038,829	5,212,160	276,494,522
2	Shtesat per 2019	-	316,000			1,080,000	1,396,000
3	Paksimet per 2019						
Gjendja e AAM-ve me							
4	31.12.2019	65,263,949	189,913,194	7,382,390	9,038,829	6,292,160	277,890,522
II Amortizimi I AAM-ve							
1	Gjendja me 31.12.2018	23,522,962	130,849,795	4,934,734	6,524,588	2,744,998	168,577,077
2	Shtesat per 2019	2,087,049	11,775,897	489,531	537,928	637,432	15,527,837
3	Paksimet per 2019	-	-	-	-	-	-
4	Gjendja me 31.12.2019	25,610,011	142,625,692	5,424,265	7,062,516	3,382,430	184,104,914
Vlera neto AAM							
III	31.12.2019	39,653,937	47,287,503	1,958,125	1,976,312	2,909,730	93,785,608

8. Gjendja e e aktiveve afatgjata jo materiale eshte paraqitur me vlere neto me 31.12.2019 ne shumen 272,039 leke

Nr	Aktivitet afatgjata jomateriale	Viti 2019	Viti 2018
1	Program finnciar	272,039	320,045
	Totali I AA jo materiale	272,039	320,045

Si politike kontabel per kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston (SKK-5). Vleresimi fillestar ne momentin e hyrjes eshte bere me kosto dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus zhvleresimin e akumuluar dhe ndonje humbje nga renia e vleres. Drejtimi nuk ka llogaritur renie te vleres per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018.

Bilanci kontabel, Pasivet

9. Detyrimet Afatshkurtra

Ne kete post paraqitet gjendja e detyrimeve afatshkurtra me 31.12.2019 ne shumen 38,359,868 leke.

Nr	Detyrimet afatshkurtra	Viti 2019	Viti 2018
1	Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimi	16,401,343	24,298,975
2	Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqerore	1,748,234	1,721,480
3	Të pagueshme për detyrimet tatimore	10,557,857	4,202,588
4	Të pagueshme për hua	9,564,081	
5	Te tjera detyrime	88,353	36,450
	Totali I detyrimeve	38,359,868	30,259,496

- Te pagueshme ndaj furnitoreve

Ne kete ze eshte perfshire gjendja e furnitoreve te palikuiduar me 31.12.2019 ne shumen 16,401,343 leke.

Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve

Ne kete ze eshte perfshire detyrimi ndaj punonjesve dhe sigurimeve me 31.12.2019 ne shumen 1,748,234 leke, si me poshte:

Nr	Të pagueshme ndaj punonjësve	Viti 2019	Viti 2018
	Paga dhe shperblime	0	156,179
	Sigurime shoq. dhe tap	1,748,234	1,565,301

Totali I detyrimeve ndaj punonjesve

1,748,234

1,721,480

• Detyrime tatimore

Shuma e detyrimeve tatimore te palikuiduara deri me 31.12.2019 eshte 10,557,857 leke, si me poshte:

Nr	Detyrimet tatimore	Viti 2019	Viti 2018
	TVSH	6,165,819	4,202,588
	Tatim ne burim	34,161	
	Tatim Fitimi	4,357,877	-
	Totali I detyrimeve tatimore	<u>10,557,857</u>	<u>4,202,588</u>

• Të pagueshme për hua, 9,564,081 lekë

Është vlera e konvertuar në lekë e huasë lënde e parë Letër sipas kontratës së huamarrjes Nr 706/3 datë 21.11.2019. Kthimi i huasë do të behët gjatë vitit 2020.

• Të tjera detyrime, 88,353 lekë,

është vlera që shoqëria jonë duhet të likuidoje ndaj shoqerive te tretëve për llogari të punonjësve konkretisht : 24000 leke detyrim permbarimore i punonjeses M.Subashi si dhe shpenzime telefon Albtelecom punonjësit 64 353 shumë për të cilën i është bërë ndalesa nga paga Dhjetor 2019

10. Detyrimet Afat Gjata

	Viti 2019	Viti 2018
1 Grante	3,388,795	3,527,349
Totali	<u>3,388,795</u>	<u>3,537,349</u>

Vlera 3,388,795 leke : grandet nga Banka e Shqipërisë

2. Kreditorë të tjerë (llogari në pritje për vendim marrje) 4,375,346 lekë

	Viti 2019	Viti 2018
2. Kreditorë të tjerë	4,375,346	4,375,346
	<u>4,375,346</u>	<u>4,375,346</u>

Kjo shume eshte k/partia e të tjera detyrime, shume kjo e cila ishte pasqyruar ne te ardhura te shtyra deri me 31.12.2017

Sa më lart, pritet të ndiqen procedurat juridike nga institucioni për arketimin e shumës



[Handwritten signature]

11. Kapitali

Tabela e meposhtme pasqyron levizjet ne grupin e kapitaleve te veta te shoqerise.

Bazuar në Vendimin Nr 6 datë 11.02.2019 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve "Për Zmadhimin E Kapitalit Të Shoqërisë " Shtypshkronja e Letrave me Vlerë" ShA, Kapitali shoqërisë bëhet 430,238,000 lekë

Nr	Kapitali dhe rezervat	Viti 2019	Viti 2018
1	kapitali I nenshkruar	430,238,000	160,000,000
2	Rezerva ligjore	22,457,849	19,268,191
3	Rezerva per investime	54,224,187	269,280,346
4	Rezerva te tjera	884	924,474
5	Rezerva per shperblim	0	34,064
6	Fitime e humbje e vitit ushtrimor	90,143,504	63,793,161
	Totali I kapitalit	597,064,424	513,300,236

Pasqyra E Te Ardhurave Dhe Shpenzimeve

12. Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit

Ne kete post jane rregjistruar te ardhurat e realizuara nga shitja e sherbimeve dhe artikujve te prodhuar per vitin 2019 ne shumen 345,645,793 leke, si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2019	Viti 2018
1	Shitje sherbimesh	345,645,793	311,358,868
	Totali I	<u>345,645,793</u>	<u>311,358,868</u>

13. Te ardhura te tjera te shfrytezimit

Ne kete post paraqitet ndryshimi i gjendjes se produkteve te gatshme me 31.12.2019 ne shumen (335,896) leke.

Nr	Emertimi	Viti 2019	Viti 2018
1	Ndryshimi i gjendjes se produktit	(335,896)	(661,770)
	Totali I	<u>(335,896)</u>	<u>(661,770)</u>

14. Lende e pare dhe materialet te konsumueshme

Ne kete post jane perfshire konsumi i materialeve dhe i mallrave te pasqyruara analitikisht me poshte ne shumen 144,246,829 leke:

Nr	Emertimi	Viti 2019	Viti 2018
1	Lende e pare dhe materiale te konsumueshme	144,246,829	131,940,871
	Shuma	<u>144,246,829</u>	<u>131,940,871</u>

15. Shpenzime personeli

Jane paraqitur shpenzimet e shoqerise per personelin ne shumen 71,409,905 leke si me poshte:

Nr	Kosto e Punes	Viti 2019	Viti 2018
1	Shpenzime per paga	61,593,111	61,948,323
2	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	9,816,794	9,883,174
	Shuma	<u>71,409,905</u>	<u>71,831,497</u>

Të detajuara përkatësisht:

Administrata 14,629,671 lekë

Reparti Makinerisë 23,395,432 lekë

Reparti Përgatitje Produkt I gatshëm 11,908,909 lekë

Sektori Prodhim –Procedura 5,380,224 lekë

Reparti shërbimeve 4,015,620 lekë

Fondi vecante (shperblim per dalje pension,ndihmese shendetsores) 64,000 lekë

Keshilli Mbikëqyrës Shoqërisë 2,199,255 lekë

16. Shpenzime amortizimi

Ne kete post paraqiten shpenzime per amortizimin e AQT-ve per vitin 2019 ne shumen 15,575,844 leke, amortizimi AAM eshte 15,527,837 leke dhe amortizimi i aktiveve jo- materiale eshte 48,007 leke.

Nr	Emertimi	Viti 2019	Viti 2018
1	Amortizimi i aseteve	15,575,844	18,542,271
	Shuma	<u>15,575,844</u>	<u>18,542,271</u>

17. Shpenzime te tjera shfrytezimi

Ne kete post jane te perfshira shpenzime ne shumen 8,316,617 leke si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2019	Viti 2018
1	Sherbim postar dhe tel	110,094	136,824
2	Taksa automjeti	161,686	162,000
3	Taksa vendore	351,180	377,865
4	Demshperblime per paga, permbarim,kamata etj	558,498	3,676,857
5	Sherbime bankare	37,955	25,200
6	Dieta personeli	-	4,000
7	Sherbim interneti	-	7,917
8	Sherbim roje private	2,376,042	2,998,152
9	Jashte perdorimi Inventar	-	166,198
10	Energji + uje	2,304,514	2,442,861
11	Siguracion ndertese	399,300	399,500
12	Mirembajte e riparime	146,000	434,000
13	Ekskursion turistik	795,000	674,500
14	Riparim testim kolaudim fikse zjarri	-	97,000
15	FV xhama	-	87,500
16	FV Gips + izolim	-	49,300
17	Punime hidraulike	86,290	-
18	Ekspert auditimi pasqyra financiare	255,000	255,000
19	Ekspert procedura e Bashkimit me Tipografine Ushtarake	-	450,000
20	Ekspert vleresimi ne Gjykate	-	40,000
21	Ekspert për hartimin e raportit të Zmadhimit të kapitalit	-	180,000

22	Analiza e formatit te certificates, Inspektoriati Shteteror teknik	18,000	18,000
23	Ndertim faqe interneti	70,000	-
24	Blerje blloqe tvsh Aplikime QKR (Arke Banke)	2,280	12,000
25	Takse gjyqesore 1% 58440 leke + pagese permbarimi per ekzek Vendimi 258920	-	317,360
26	Sherbim printer (ne 2019 vlere 445000 leke është bërë npm magazines lendes ndihmese)	445,000	
27	Konsum karburant (ne 2018 vlere 272107 leke rregjistruar tek material I konsumuar)	199,778	
		8,316,617	13,012,038

18. Te ardhura te tjera

Ne kete post paraqiten te ardhura te tjera ne shumen 389,038 leke, te detajuara si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2019	Viti 2018
1	Rimarrje grantesh	138,554	155,604
2	Te ardhura te tjera (penalitete levrim vonuar, ndales punonjesit etj)	250,484	173,610
	Totali I te ardhurave	389,038	329,214

19. Llogaritja e tatim fitimit

Shoqeria per vitin ushtrimor 2019 paraqitet me nje fitim neto prej 90,143,504 leke. Shpenzimet e pazbritshme jane ne shumen 558,498 lekë.

Nr	EMERTIMI	Viti 2019	Viti 2018
1	Te ardhura	346,034,831	311,688,082
2	Shpenzime	(239,885,091)	(235,988,447)
3	Rezultati i ushtrimit	106,149,740	75,699,635
4	Shpenzime te pazbritshme <i>Gjoha, kamata, demshperblime</i>	558,498 558,498	3,676,857 3,676,857
5	Rezultati tatimor	106,708,238	79,376,492
6	Tatim fitimi	16,006,236	11,906,474
7	Fitimi / humbja neto	90,143,504	63,793,161

20. Angazhime dhe pasiguri

Çeshtje gjyqesore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta

21. Ngjarje pas datës së Bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Administratori

Besmir HYSA

Kryetare Dege Finance

Besjana DERVISHI